

**9.01.2025  
Ora 12:07**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim: “Për miratimin e Rregullores për shqyrtimin nëpërmjet PER të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
- **Stafi KQZ: Znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.**

**Parti Politike: PD (z. F. Nuri), PS (znj. E. Xhina)**

**Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita, atëherë në seancën e sotme kemi në rend dite vetëm projektvendimin “Për miratimin e Rregullores për shqyrtimin nëpërmjet PER të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”, çështje e shtyrë nga seanca e djeshme. Përfaqësuesit e partive politike janë prezent. Nuk e di, përfaqësuesi i Partisë Demokratike i dha disa mendime dje në lidhje me draftin. Përfaqësuesia e Partisë Socialiste, në lidhje me draftin?

**Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS:** Faleminderit, zoti Komisioner. Pasi na u dha mundësia për ta shqyrtuar më mirë draftin, paraqesim disa mendime, apo opinione lidhur me të nëse mundet të integrohen në tekstin e draftit. Psh, në faqen 9 të draftit lidhur me pikën e tretë “Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim nga ana e personelit të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Murat Dule*

*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt. 8.01.2025*

autorizuar nga KQZ-ja.”, thuhet: Gjatë shqyrtimit të kérkesës për regjistrim, Specialisti mund të kryejë këto veprime në Modulin e Shqyrtimit të Kérkesave në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER) të zgjedhësve nga jashtë vendit:

- a) miratojë kérkesën;
- b) refuzojë kérkesën;
- c) ta shtyjë në kohë marrjen e këtij vendimi për t’ju rikthyer më vonë.

Ne propozojmë që ndoshta duhet vodosur një afat, sa kohë duhet ky specialist ta shtyjë vendimmarjen në lidhje me kérkesën. Duke pasur parasysh që mund të ketë raste të tejkalojet ky afat 5-ditor që u vendos nga Komisioni Rregulator, por që rregullohet më lart ku thuhet “për shkaqe të arësyeshme të ngarkesës etj”. Mendoj që do të ishte me vend vodosja e një afati maksimal, kur mund t’i rikthehet specialisti shqyrtimit të kérkesës që shtyhet për një kohë tjeter. Gjithashtu “specialisti bën vendimmarjen e tij, shqyrton dokumentacionin sipas aktit”. Propozojmë në fjalinë ku thuhet që: “Ky dokument duhet të ketë në përbajtjen e tij adresën e zgjedhësit si dhe të jetë lëshuar në emër të tij dokumenti”, ne propozojmë që të mos jetë kaq e ngushtuar si fjali, sepse mund të ndodhë që dokumenti mund të ketë pesë, gjashtë emra dhe ndër to të jetë dhe emri i aplikuesit. Të parashikohet dhe ky rast duke thënë që: “Të jetë lëshuar në emër të tij, ose një ndër emrat që përban dokumenti të jetë dhe emri i tij”, për t’i paraprirë rasteve që mund të ndodhin gjatë aplikimit. Sa i takon pikës së fundit, “Nëse kérkesa refuzohet, specialisti për shqyrtimin e kérkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do duhet të zgjedhë arsyen e refuzimit sipas listës shteruese të dhënë në formatin e vendimit të refuzimit”. Kam bindjen që lista shteruese, patjetër duhet t’i përbajë të gjitha opsonet, sepse nuk do të donim që “kérkesa refuzohet”, të shoqërohet me një fjali të thatë “sepse nuk keni plotësuar kushtet dhe kriteret”. Por kjo të jetë e qartë që dhe aplikuesi ta kuptojë se çfarë nuk

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt. 8.01.2025*

është kuptuar në aktin që ai ka ndërmarrë. Do të donim që të ishte e mundur që përveç arësyes së refuzimit, specialisti të mund të bënte dhe shënimin që: “zgjedhësi ka të drejtë të riaplikojë sërisht në platformë”. Kjo, sepse ndoshta jo të gjithë e kanë informacionin e duhur që mund të përsërisin kërkesën. Duke bërë këtë kujtesë që “ju mund të aplikoni sërisht”, do ta ndihmonim zgjedhësin që të hapte një llogari të re dhe të aplikonte përsëri. Tani sa i takon dhe kërkesave që solli dhe kolegu në seancën e djeshme, do të preferoja në fakt që: “në rast refuzimi, të vendoseshin në dispozicion të audituesve teknicienë”. Ata kanë të drejtë në fakt, që t'i shqyrtojnë sipas vendimmarrjes tuaj të djeshme, por dhe vendimmarrjes së Rregullatorit, me vendimin nr. 10, që ata mund të kontrollojnë procesin, ta monitorojnë. Ndoshta do të na ndihmonte nëse do ta vendosnim si detyrim në këtë akt, që: “rastet e refuzimit, specifikisht duhet t'i vihen në dispozicion audituesve”. Partitë pastaj të kenë mundësinë që kur kanë indicie për ndonjë mosrespektim të dispozitave, të mund të venë në lëvizje KQZ-në. Këto ishin mendimet tona në lidhje me këtë akt, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Ka përfaqësuesi i Partisë Demokratike ndonjë koment në lidhje me këto propozime?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Jo, nuk kemi ndonjë koment të veçantë specifik, tej atyre që ne shtjelluam dhe në seancën e djeshme. Sugjerimet tona për ato dy pikat kryesore që të ketë transparencë në lidhje me vendimmarrjen e operatorëve. Pra, që edhe kur miratohet, por dhe kur refuzohet një aplikim i caktuar nga zgjedhësit nga jashtë mund të aksesohet qoftë dhe.., po themi nga stafi, apo audituesit teknicienë që të mund të rikuperohen të dhënat, nëse operatori ka gabuar. Pra, të ketë transparencë por dhe të rikuperohen të dhënat. Këto dy elementë do të donim, plus dhe faktin, e

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt. 8.01.2025*

ripërsërisim dhe një herë atë që thamë dje për vendimmarrjen e KQZ-së, e cila në çdo rast, ne e kërkojmë që të jetë një vendimmarrje që të vijë në fund nga ana juaj si titullar i institucionit. Kjo të mos jetë thjesht një përgjegjësi e specialistit, apo e personit që do të ngarkohet me detyrën funksionale, për të parë, apo për miratuar në platformë aplikimet për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë. Lidhur me propozimet e ardhura nga kolegia, unë mendoj se janë në vazhdën e duhur për të përmirësuar sistemin. Bashkohem me idenë që do të duhet që në kthimin e një përgjigjeje, në rast se aplikimi është i paplotë, është e domosdoshme që të specifikohet se çfarë mungon tek aplikimi. Vetë zgjedhësi, nëse është i interesuar ta vazhdojë procesin, të dijë se çfarë të rregullojë në aplikimin e tij që ta kryejë e ta përfundojë atë, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Vendimi i pranimit prespozon që ai është në listën e zgjedhësve. Ndaj këtij vendimi nuk mund të ankohet sepse është përbushur kërkesa e tij dhe normal nuk ka për çfarë të ankohet. Ndaj vendimit të refuzimit, drafti i vendimit, ne mund ta ndajmë në fakt, i shkon automatikisht në emër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, aplikantit, e përmban arësyen sepse i është refuzuar kërkesa dhe është shumë e qartë. Ai e kupton se nuk i është pranuar, sepse i mungon dokumenti që ka lidhje me adresën që ka deklaruar ai. Rastet janë shumë të limituara. Praktikisht një, ose dy raste janë kur mund t'i refuzohet kërkesa. Pjesa tjeter e verifikimit të kërkesës bëhet në mënyrë automatike, përputhje e identitetit, e fytyrës, etj.. E vetmja gjë që do të duhet të shqyrtojë Komisioneri është nëse e kemi ngarkuar dokumentin që të lidh me adresën që ti ke deklaruar dhe nëse e ke plotësuar fushën e adresës. Pra, në arësyetim, kjo do të jetë e qartë, do të jetë vendim i Komisionerit. Pra, do të jetë një akt administrativ, i cili ka dhe sqarimin që kërkoi të ishte dhe përfaqësuesja e Partisë Socialiste. Zgjedhësit i thuhet që “Ju mund të riparaqesni pa asnjë kufizim këtë kërkesë deri në momentin... deri në datën 4 mars

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt. 8.01.2025*

kur mbylltet procesi i aplikimeve. Nëse dikush thotë që: “Unë mendoj se jam në rregull, as dua të hyj më te “PER”, ju ma keni refuzuar kërkesën”. Atëherë mund të shkojë në gjykatë, me të cilën besoj nëpermjet këshilltarëve gjyqësorë, ne kemi adresuar edhe çështjen e paraqitjes së ankesës e të tjera si këto, por nuk është momenti ndoshta për t'i diskutuar. Pra, me pak fjalë, ai është i qartë për arësyen dhe është i qartë që nëse do ta ripërsërisë kërkesën e ripërsërit. Për sa i përket procesit të kontrollit dhe të marrjes së informacionit se çfarë është bërë me secilën prej kërkesave? Dy audituesit, por dhe ndihmësat e tyre, kanë akses të plotë për të verifikuar të gjithë setin e kërkesave të ngarkuara në platformë dhe se çfarë ka ndodhur me secilën prej tyre. Nga pikëpamja formale, juridike ato janë akte të Komisionerit Shtetëror dhe është e qartë që nëse ka një numër të lartë aplikimesh, kushdo individ i vetëm nuk do ta kishte kohën fizike që secilën prej tyre ta shihte. Pra, secilën prej procesimeve të specialistit ta shihte. Ndaj është zgjidhur mekanizmi i autorizimit siç ishte dhe për raste të tjera të delegimit apo të autorizimeve për të përfaqësuar autoritete në procese të caktuara. E kuqtoj shumë mirë këtë. Mund të ndodhë që nga pakujdesia dikush të gabojë, por në këtë moment nuk e zgjidhim dot këtë. Më së pari, për një arësy ligjore dhe praktike, sepse do të duhet që Komisioni Rregulator ta ndryshojë. Mund ta propozojmë që ta ndryshojë. Pra, ta shtojë në atë procedurën që ata kanë miratuar “të shqyrtimit të kërkesave”. Ne nga pikëpamja teknike e realizojmë dhe e kemi gati, por që të futet një faktor, një element tjetër do të duhet që ta legjitimojmë këtë. Për mua nuk ka problem, unë jam dakord për ta bërë dhe është diçka që bëhet nga pikëpamja teknike. Meqenëse ju të dy si palë politike e pranoni këtë zgjidhje, për ne nuk ka problem edhe pse vetë jam i bindur që kjo është e panevojshme, sepse sikurse mund të gabojë operatori, teorikisht edhe mbikqyrësi i këtij specialisti. Në fund të fundit ai është gabim i Komisionerit Shtetëror. Si do ta adresojmë këtë gabim? Ky është problemi, sepse kjo është më e

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të*


*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt. 8.01.2025*

rëndësishme. Ndaj gabimit të Komisionerit mund të ankohet vetëm personi i interesuar. Unë mendoj se kemi një zgjidhje. Nëse ne biem në dijeni të faktit që ky vendim i Komisionerit është gabim dhe për këtë na mjafton dhe notifikimi nga audituesi dhe nuk do të kishim nevojë për këtë. Ka një mekanizëm ligjor për ta bërë këtë. Ai është akt administrativ, i marrë nga një organ administrativ, në rastin konkret nga Komisioneri, brenda afatit të ankimit të aktit administrativ, vetë organi administrativ mund ta revokojë atë. Kështu ndoshta nuk do të ketë nevojë për rregullim nga Rregulatori, mendoj unë. Gjykoj se e ka këtë kompetencë Komisioneri Shtetëror. Gjithësesi, nëse për ju, mendojeni dhe një herë, qëndron me interes ajo çfarë thatë, ne mund ta akomodojmë që të shtojmë dhe një hallkë tjetër të kontrollit. Me sa kuptoj gjithë shqetësimi juaj është që në rast se ndodh një gabim i tillë për çfarëdolloj arësyje, si do ta korigojmë? Ose do ta korigojmë nëpërmjet mekanizmit të ankimit, po ndoshta ai zgjedhësi mund të mos ketë vëmendjen. Ju si parti politike që keni gjithë vëmendjen te ky proces, do të na njoftoni dhe të na thoni "ky vendim është marrë jo siç duhet" dhe do ta rikonsiderojmë. Në çdo rast përsëri do të jetë një veprim, një akt i Komisionerit. Këtë kemi kohë ta mendojmë dhe për ta adresuar, nëse vazhdoni t'i qëndroni kësaj idesë që dhe nga pikëpamja teknike të kemi një hallkë të shtuar monitoruese. Për ato të tjerat jemi dakord për t'i përfshirë. Në lidhje me këtë shtyrjen në kohë të marrjes së këtij vendimi, në fakt kjo nuk ka të bëjë me shtyrjen tej afatit pesë ditor. Në momentin kur ti hyn mundet të mos e miratosh në atë dhe nga pikëpamja teknike, specialisti, apo Komisioneri të themi, e ka mundësinë edhe pse hyn e shqyrton atë kérkesën, mund të shtyjë shqyrtimin e saj, por në çdo rast do të jetë brenda pesë ditëve. Këtë, ne nuk mund ta negociojmë dot, sepse është e vendosur tashmë. Nëse do të rezultojë se gjatë shqyrtimit të kérkesave kjo del e nevojshme, do të kërkojmë që ta akomodojmë nëpërmjet ndryshimeve përkatëse, kjo exigencë. Në rastin konkret, mbetet brenda afatit pesë ditor. Mirë, e

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

përfundojmë këtu, nëse nuk kemi ndonjë gjë tjeter edhe e miratojmë aktin me këto  
ndryshime të cilat i arësyetuam pak më lart. Kemi gjë tjeter? Nuk kemi!

Mirë, faleminderit seanca mylllet, ditë të mbarë!

---

**Vendimi nr. 23**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

